



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 19.10.2021

**NJOFTIM**

**ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHETËSE DIREKTE TË VITIT 2021**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE, si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 331, datë 04.08.2021, “Për rialokimin e fondit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021”

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021.

**Agropikat** janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve që janë përfshirë mbi vijën e financimit.

- **Masa 3:** Zëvendësim plasmasi në sesa ekzistuese – Vija e financimit ishte në numrin rendor 593, për kodin e aplikimit me numër 11943 - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 608, për kodin e aplikimit me numër 12041.
- **Masa 4:** Mbjellje Bimë Aromatike dhe medicinale –Vija e financimit ishte në numrin rendor 117, për kodin e aplikimit me numër 1885 - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 118, për kodin e aplikimit me numër 1909.

Afati i dorëzimit të dokumenteve shtesë për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit të shpallur në datën 19.10.2021 është deri më datë **03.11.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.